



# Buletini Alb-Shkenca

ORGAN I PERMUJSHEM I STUDIUESVE DHE DASHAMIRRESVE TË SHKENCES NE TROJET SHQIPTARE DHE NE BOTE ■ Mars 2005  
<http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca> ● [www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org) ● e-mail [alb-shkenca@alb-net.com](mailto:alb-shkenca@alb-net.com)

## FAN NOLI DHE KOSHIENCA SHQIPTARE

At Artur Liolin\*

Në adresën e Alb-Shkencës ka mbërritur kumtesa e mëposhtëme e cila, ndonëse e shkruar 11 vjet më parë, ka ende vlera aktuale dhe shpresojmë se do të lexohet me interes nga anëtarët e forumit tonë.

Fan Noli ishte njeri i të gjitha kohërave. Tërë jetën, talentin dhe aftësinë e tij të pashoqe ai i vuri në shërbim të popullit shqiptar. Në fe dhe letërsi, qeverisje dhe gazetari, studime shkollore dhe muzikë, ai u përpoq t'i jepte popullit të vet – aq të vuajtur nën pushtimin shekullor – një bazë të shëndoshë për të rirbuluar identitetin kombëtar pas disa shekujsh shtypjeje dhe asimilimi kultoror. Në këtë drejtim, ai e përqëndroi tërë energjinë e tij intelektuale e shpirtërore me një vullnet të paparë në lëmitë ku ai e pa të domosdoshme, sepse ai e kish kuptuar mirë thënien biblike: “Një popull pa vizion zhduket”.

Çdo pjesë e punës që ai kreu gjatë jetës përbën një përpjekje të vetme për ndërtimin e kombit dhe ngritjen e koshienca kombëtare. Po përdor fjalën koshienca me qëllim, për ta dalluar këtë kategori shoqërore nga ksenofobia e ligë që po u kërcënohet shumë shteteve tani kur po kalojmë në shekullin tjetër. Kjo përpjekje e Nolit në berthamë çonte drejt bashkimit dhe afrimit e nuk ndante apo perjashtonte. Le të shohim disa aspekte.

Shqiptarët ortodoksë po balla-

faqoheshin me pengesa të mëdha në përpjekjen e tyre për të krijuar një kishë kombëtare në gjuhën e tyre, përpjekje kjo plot martirizime e sakrifica. Kështu, në fillim si prift në vitin 1908 dhe pastaj si peshkop, Noli vuri themelin e një kisha autoktone përmes perktimeve e botimit të librave kryesorë të shërbimit fetar dhe duke frymëzuar shpalljen e autoqefalisë në vitin 1922. Për këtë ai u quajt, pas Shën Palit, apostulli i dytë i shqiptarëve. Bash për këtë arsye, mbështetja që ai pati prej popullatës muslimane, katolike, protestane, hebreje si dhe asaj kristiano-ortodokse dhe bile edhe të mosbesimtarëve ishte shpreje e një bashkëpunimi kulturor midis tyre, që më vonë u bë standard për shoqëritë multikulturale.

Në fillim të këtij shekulli, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Shqipëria u gjend pa një arkiv kombëtar. Si një at i urtë, Noli përktheu në shqip në mënyrë sistematike kryeveprat e autorëve dhe poetëve të mëdhenj botërorë, duke u shtuar atyre veprat e tij origjinale, të cilat vazhdojnë të jenë frymëzim i intelektualëve tanë për të menduar, kompozuar, shkruar dhe krijuar në gjuhën e tyre të unifikuar.

Dimensionet kozmopolite të të menduarit, entuziazmi patriotik, ironia ideologjike dhe rrëfimi i thjeshtë karakterizuan gjuhën e tij, ndërsa me individualitetin e tij të madh dhe respektimin e parimeve në veprat e tij,

me forcën tronditëse të luftërave të tij personale, të dyshimeve dhe epifanive u jepte shkri-meve të tij një vërtetësi çliruese: vullnë e një njeriu të ndershëm.

Para më pak se një shekulli, vendet e banuara për mijëra vjet nga shqiptarët ishin ende pjesë të papërcaktuara të perandorive dhe konfiguracioneve gjeopolitike të huaja. Dihet nga të gjithë se gjysma e popullit shqiptar jeton jashtë kufijve të Shqipërisë dhe se shumica e tyre janë të privuar nga të drejtat më elementare njerëzore dhe civile të mbledhjeve dhe të shprehjes se lire. Meqë Shqipëria që shndërruar në një korridor për fiset endacake dhe për ushtritë pushtuese, banorët e saj shpesh reflektonin divergjenca kulturore. Por megjithatë, ky popull antik mbeti kompakt dhe në thelb homogjen deri në ditët e sotme.

Si themelues i Federatës Pan-shqiptare (Vatra) dhe botues i gazetës *Dielli*, Noli prej viteve 1909 deri më 1919 udhëtoi në vende të ndryshme ku banonin shqiptarët dhe ku ata kishin të drejtë organizimi, gjë që ishte mohuar në vendin e tyre autokton. Shtetet e Bashkuara ishin një nga këto vende që e mirëpritin Nolin. Këtu ai fitoi respektin e presidentit amerikan Woodrow Wilson më 1918 dhe perfaqesoi Shqipërinë në Gjenevë më 1920, duke siguruar kështu futjen e saj në Kombet e Bashkuara.

Duke fituar admirimin e shoqëve dhe respektin e bashkëdhetarëve të rinj të ndërgjegjshëm, ai shërbeu si anëtar parlamenti, ministër i Punëve të

jashtme dhe kryeministër: një karrierë diplomatike që vetëm do të kishte kërkuar një jetë të tërë për t'u përmbushur.

Një provë tjetër për orientimin, durimin dhe ndërgjegjen e tij që mërgimi i tij politik në vitin 1925, kur ai ia kushtoi jetën kishës së tij, studimeve shkencore dhe zgjerimit të veprimtarisë letrare. Muzika shqiptare, që kishte lindur nga temat antike të luajtura me instrumenta antike, ishte ende e lokalizuar dhe e kufizuar në ritualet e fshatrave. Kështu Noli u regjistrua në New England Conservatory për të marrë mësim në një fushë krejt tjetër. Duke kompozuar një rapsodi shqiptare dhe *Uverturën bizantine*, ai u dha shqiptarëve një shembull: se çfarë ishte bërë nga të tjerët mund ta bënin edhe ata vetë. Nëse ai mund t'a bënte këtë, nuk kishte pse të mos t'a bënin edhe ata. Ishte ky një mesim për kurajo. Për këtë ai është njeri nga modelet kryesore për vendin tonë.

Në Shtetet e Bashkuara ai pat studiuar historinë dhe shkencat politike në Harvard (1909-1912) dhe më vonë në Universitetin e Bostonit, gjithmonë duke përpjekur për të bartur shpirtin e demokracisë dhe qytetërimit amerikan në tokën e të parëve të tij, duke arritur kulmin e përpjekjeve me reformën agrare që bëri qeveria e tij në vitin 1924. Në këtë kohë Shqipëria ballafaqohej me pengesa të mëdha që nuk lejonin ndryshime, si ekonomia e varfër, mentaliteti feudal, besnikëria ndaj klaneve primitive, numri i vogël i miqve dhe numri i madh i kundërshtarëve grykës. Kjo ishte një iniciative e guximshme, që edhe sot na habit për nga trimëria dhe largpamësia. Qeveria dhe përkrahësit e tij pasqyronin më së miri shumëllojshmërinë krahinore dhe fetare, gjë jo e zakonshme në atë kohe që dëshmonte për toler-

ancën dhe zemërgjerësinë e të gjithë drejtuesve shqiptarë të këtij zgjimi kombëtar. Gjatë tërë kohës Nolin, kuptohet për interesat të ngushta, shumë e shpallnin si të vetin, por ai kurrë nuk u bë vegël e asnjë pale.

Nuk ka dyshim se kishte edhe kontradikta të brendshme në këtë eksperimentim fillestar të lirisë dhe të një qeverisjeje iluministe. Realiteti politik i kohës, mungesa e një baze të përshtatshme arsimore, pavendosmëria e tij që menjëherë të formonte një bazë kushtetutare, mbështetja e tij vetëm në mjeshtërinë diplomatike dhe presionet e panumërta nga jashtë ishin gabime të trashëguara që pengonin suksesin e menjëhershëm. Duhej kohë, por kohë ai nuk pati. Sidoqoftë, qeveria e vitit 1924 që fillimi: një pranverë e shkurtër por e ndritur që edhe sot frymëzon zemrat dhe mendjet e atyre që aspirojnë një Shqipëri demokratike, të lulëzuar dhe të barabartë, me besim të plotë në vetevete, por gjithmonë e gatshme për të bashkëpunuar me fqinjët e ndershëm në rajon, në kontinentin e saj dhe në tërë botën. Një Shqipëri që e respekton vendin stërgjyshor, por mbron edhe parimet universale të drejtësisë... Një Shqipëri e zellshme për të rritur potencialin e saj ekonomik, por dhe e vetëdijshme për grykësinë njerëzore, shfrytëzimin dhe mungesën e përgjegjësisë ekologjike. Një Shqipëri e udhëhequr nga njerëz të aftë dhe të besuar, por që në të njëjtën kohë i japin llogari parlamentit dhe elektoratit të tyre. Një Shqipëri që respekton lirinë e besimit dhe shumëllojshmërinë fetare, por që nuk lejon fanatizmin ekstrem. Një Shqipëri që përkrah talentin dhe ëndërrat e qytetarëve të saj plot gjallëri, por që edhe pranon parametrat e provuara nga koha të ligjit kushtetues dhe të konventave ndërkom-

bëtare. Por ky synim i vlefshëm ka edhe çmimin e vet. Bashkë me lirinë vjen edhe detyra, me krenarinë kombëtare duhet të vijë edhe përgjegjësia, me dëshirën për tokën dhe pasurinë personale duhet të vijë edhe shpirtgjerësia dhe synimi personal duhet të përputhet me mirëqenien e përgjithshme. Në fund të fundit këto janë çeshtje të ndershmërisë dhe drejtësisë, të mëshirës, trimërisë dhe mikpritjes. Këto janë çeshtje të etikës dhe moralit që përbëjnë ndërgjegjen e një kombi. Të gjitha sistemet jetëgjata demokratike kanë këtë element të domosdoshëm si bazë. Noli e dinte këtë dhe për këtë u mundua ta kultivonte në të gjitha fushat e lartpërmendura.

Republika e Shqipërisë sot, me udhëheqjen e saj ekzekutive dhe gjykatën, qytetarët dhe diasporën, klerikët dhe fermerët, minatorët dhe mësuesit, tregëtarët dhe mjekët, ushtarakët dhe intelektualët, shumicën dhe pakicën e saj ka detyrë para brezave të ardhshëm dhe vetvetes të shfrytëzojë rastin për ta mbushur jetën e tyre me liri, siguri dhe nder.

Duhet të jemi të bindur se realiteti demokratik i Shqipërisë sot ende mbetet të perceptohet plotësisht, të absorbohet dhe të zbatohet plotësisht. Është gjithashtu e qartë se ky proces filloi vetëm para ca vitesh dhe si i tillë nuk mund të mohohet. Janë të shumtë ata që përjetuan çnjerëzimin dhe manipulimin në mungese të demokracisë. Pavarësisht nga provat dhe sfidat që duhet të përballojnë koshienca dhe vullneti i këtij vendi, ka shenja shpresëdhënëse se populli shqiptar po përpjet t'i tejkalojë pengesat e mëdha dhe të sigurojë vendin e tij të merituar në këtë botë.

Qeveria e Nolit e vitit 1924, ishte faza e parë dhe do ta ruajë përherë vendin e saj si lajmëtar i idealit demokratik në Shqipëri.

(vijon në faqen 12)

## FERDINAND ALIMADHI



Duke i uruar Ferdinand Alimadhit mirëseardhjen tek Alb-Shkenca, më poshtë po japim një përmbledhje të shkurtër të veprimtarisë së tij studimore-shkencore.

Pasi kreu studimet më 1998 në Universitetin e Tiranës në degën e Informatikës (Shkencat e kompjuterit) gjatë viteve 1998-2000 punoi si programator në Mini-

strinë e financave të Shqipërisë dhe simulimi i përparuar (Modeling and Simulation Advanced), Sistemi kompleks i simulimit (Complex System Simulation), Metodrat numerike (Numerical Methods).

Gjatë viteve 2000-2002 studion dhe mbron diplomën e masterit në shkencat e kompjuterit në Universitetin e Amsterdamid, Hollandë.

Gjatë kësaj periudhe ai ndoqi me sukses një sërë kursesh si Programimi i përparuar në Java (Advanced programming in Java), Programimi Lisp për inteligjencën artificiale (Lisp programming for artificial intelligence), Vizualizimi shkencor dhe realiteti virtual (Scientific Visualization and Virtual Reality), Kompjuterizimi paralel shkencor dhe simulimi (Parallel Scientific Computing and Simulation), Simulimi stokastik (Stochastic Simulation), Modelimi

dhe simulimi i përparuar (Modeling and Simulation Advanced), Sistemi kompleks i simulimit (Complex System Simulation), Metodrat numerike (Numerical Methods).

Nga viti 2002 deri në maj 2004 ai ishte lektor në Universitetin e New Yorkut në Tiranë.

Gjatë kësaj kohe emigron në Amerikë dhe fillon punë në një nga universitetet më të famshëm në botë, Massachusetts Institute of Technology (MIT).

Qysh prej nëntorit 2004 Alimadhi punon si programues e analist në Fakultetin e Artit dhe shkencave, në Institutin e studimeve sasiore të shkencave shoqërore pranë Universitetit të Harvardit.

Interesat akademike kryesore të tij në fushën e shkencave kompjuterike janë teknologjia e internetit: protokollat XML, PHP-MySQL, WAP; teknologjia J2ME, PDA etj.

**T**ë nderuar lexues, ditët e ardhshme dëshirojmë që të organizojmë një sondazh në faqen tonë në internet për të zgjedhur studiuesin më të suksesshëm shqiptar për vitin 2004 ndërmjet anëtarëve të Alb-Shkencës. Në mënyrë që ky sondazh të jetë sa më objektiv, kërkojmë nga ju që të propozoni emrat e këtyre studiuesve të cilët do të përfshihen më vonë në sondazh. Të gjithë anëtarët e Alb-Shkencës kanë të drejtë të votojnë.

Meqenëse lista e publikimeve shkencore të vitit 2004 e afishuar në faqen e Alb-Shkencës në internet do të shërbejë si dokument bazë për këtë sondazh, do t'iu luteshim që ta konsultoni këtë dokument përpara propozimit të emrave.

## SONDAZHI I ALB-SHKENCES DHE KONTRIBUTI JUAJ SHKENCOR

Kjo është hera e parë që ne po organizojmë këtë sondazh, kështu që do të na ndihmonit shumë me mendimet tuaja se si ta organizojmë atë më mirë.

Shkrimi më i lexuar gjatë muajit të fundit ka qenë ai që përmban listën e referencave bibliografike të botimeve shkencore të anëtarëve të Alb-Shkencës gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2004.

Duke parë këtë interes të vizitorëve të shumtë, ne para disa javësh instaluar në këtë faqe një lidhje të veçantë për referencat bibliografike. Secili nga ju pa shume mundim mund të regjistrojë në këtë lidhje referencat

e botimeve të tij shkencore, të cilat menjëherë sapo futen në sistem, klasifikohen automatikisht sipas emrit të autorit dhe disiplinave përkatëse shkencore. Me ndihmën tuaj pra, ne kemi dëshirë që ta shtojmë e ta pasurojmë këtë skedar bibliografik virtual i cili mund ti vijë në ndihmë gjithësecilit. Ju ftojme të gjithëve të kontribuoni në këtë drejtim.

Nëqoftëse do të dëshironi të shtoni publikimet tuaja në këtë listë referencash bibliografike, mund ti dërgoni ato menjëherë edhe në adresat elektronike: [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org) ose [buletini@alb-shkenca.org](mailto:buletini@alb-shkenca.org).



## GJERGJ KASTRIOTI-SKENDERBEU MBROJTËS I QYTETËRIMIT EUROPIAN (1405-2005)

*Dr. Zef Mirdita,  
Profesor në Universitetin e Zagrebit, Kroaci*

Milan Schufflay, albanologu i shquar kroat dhe njeheras edhe themeluesi i historiografisë mesjetare shqiptare, duke vlerësuar lart personalitetin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ndër të tjera thotë: "Nën udhëheqjen e Skënderbeut e tërë bujaria shqiptare u bashkua tok në luftë kundër turqve. U krijua shteti i parë shqiptar, pas rënies së Konstantinopolit, Serbisë dhe Bosnjes, shteti i fundit i madh kristian në Ballkan". Ndërsa, historiani më i madh kroat i gjysmës së parë të shekullit XX, Ferdo Šišić, në një punim që ka mbetur dorëshkrim dhe ruhet në arkhivin e Akademisë së shkencave dhe arteve në Zagreb, me titull *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe koha e tij*, shkruan që në fillim: "Ç'është në mesin e poetëve Shekspiri, ç'është në mesin e oratorëve Çarls Xhejms Foksi (1749-1806), burrë shteti dhe orator britanik, ç'është në mesin e udhëheqësve ushtarakë Napoleoni, Skënderbeu në mesin e trimave është trim i vërtetë" – dhe vazhdon "përderisa kalorësit evropianë frigoreshin nga fytyrat e mërdhezura jeniçere, Skënderbeu me dorën e djathtë ka prederi dymijë turq dhe derisa mbretërit dhe perandorët që sulmoheshin nga sulltanët, të dëshpëruar dhe të frikësuar kërkonin ndihmë nëpër tërë botën kristiane, Skënderbeu me një grusht shqiptarësh trima luftoi kundër ushtrisë tejet të madhe të armikut dhe korri fitore".

E fillova këtë punim me mendime dhe konstatime të dy shkencëtarëve të mëdhenj kroatë jo për tjetër, por vetëm që të tregoj dhe dëshmoj se madhëria e Skënderbeut nuk qëndron ve-

tëm në atë se ka qenë burim frymëzues dhe shembëlltyrë e burrërisë së popullit shqiptar, por edhe i gjithë atyre popujve që lëngonin nën zgjedhën osmane të cilët luftonin për çlirimin shpirtëror-kombëtar nga nënshtrimi aziatik. Skënderbeu, jo vetëm në kohën e tij, por edhe pas vdekjes ka qenë krenaria e popujve të lirë dhe ua ka zgjatur jetën të gjithë atyre që në rrugët e gjata historike i drejtoheshin trashëgimisë së gjenit të tij. Përkishtë në dritën e këtij fakti duhet kuptuar dhe mund të kuptohet krijimi i panumërt i veprave shkencore e historike, të studimeve, romaneve, dramave, operave dhe epikës popullore.

Ndonëse nuk kam ndërmend të ndalem në paraqitjen e fitoreve të tij të shkëlqyera, mendoj se nuk është e tepërt po qe se theksohet roli i tij i pakontestueshëm dhe i paharruar në mbrojtjen e qytetërimit evropian të kohës së tij në shekullin e XV-të.

Për ta kuptuar më mirë këtë rol dhe për ta shiquar sa më saktë, është e nevojshme që personaliteti i Skënderbeut të trajtohet në kuadër të kohës kur ka vepruar, të ambientit shpirtëror-kulturor të Shqipërisë së asaj kohe dhe të rregullimit shpirtëror-politik të Europës së kohës së tij.

### AMBIENTI SHPIRTËROR, KULTUROR E POLITIK I SHQIPËRISË NË KOHËN E SKËNDERBEUT

Shqipëria, atdheu i Gjergj Kastriotit në shekullin XV-të ka qenë trashëgimtare e fuqive të ndryshme kulturore-shpirtërore siç janë: latine e bizantine, kurse politikisht nën patronatin e Republikës së Venedikut. Shqipëria e asaj kohe për nga mënyra e

jetës së dinastive apo shtëpive të mëdha vendase, madje dhe të qyteteve me statutet e tyre që ishin imitim i atyre italiane, por edhe të qyteteve të tjera të Europës perëndimore, aspak nuk dalloheshin prej tyre. Qytetet bregdetare të Shqipërisë, përveç Vlorës, i takonin kulturës dhe qytetërimit latin.

Ndërkohë, përkundrajt mbështetjes venedikase, për dallim nga strukturat e qyteteve, dinastitë e moçme në sferën politike ishin në rënie e sipër. Arsyeja për këtë duhet kërkuar në faktin se këto dinasti, e posaçërisht ato me origjinë bizantine, ishin të luhatshme në konfliktin në mes Romës dhe Stambollit. Një luhajtje e tillë u shpreh edhe në paaftësinë e tyre që t'u kundërvihen sulmeve ushtarake turke; kurse Europa dridhej nga frika dhe rreziku që po i kanosej. Kjo frikë u bë edhe më e madhe kur Stambolli-Konstantinopoli, Roma e dytë dhe qendra e Perandorisë lindore romake, por edhe e krishterizmit të ritit oriental, më 29.05.1453 ra në duart e osmanlinjëve. Kjo katastrofë jehoi tmerrshëm në tërë botën e atëherëshme kristiane dhe shkaktoi përçarje në mesin e tyre.

Bizantinët i akuzuan latinët sepse më tepër merreshin me problemin e dy kishave simotra – asaj Romake dhe Ortodokse, kurse latinët i akuzonin bizantinët për shkak të dyfytyrësisë së tyre ndaj perëndimorëve sepse më parë ishin të gatshëm t'i nënshtroheshin turbanit sulltan se sa të pranonin bashkimin e kishave dhe primatin e papës.

Që të jem më i qartë, duhet të ndalem pak në këtë problem. Këtu kemi të bëjmë me Koncilin Kishtar që mbahej në Firence qysh nga viti 1438 deri më 1442. Në këtë koncil morrën pjesë si prelatët e lartë të Kishës së Lindjes apo ortodokse, ashtu edhe ata të Kishës së Romës. Njëra

prej vendimeve të këtij koncili ishte edhe bashkimi kishtar, gjegjësisht uniatizmi. Lidhur me këtë klauzolë u vendos që të organizohet ndihma Bizantit që të ndalen sulmet e ushtrisë osmane. Mirëpo, duke iu falënderuar popullit, klerit të ulët e sidomos të murgjve të Malit Atos, vendimet e sjellura në këtë koncil mbetën vetëm në letër. Tek e fundit, edhe vetë patriku i Konstantinopojës, Genadiu, në mënyrë të hapur ishte në lidhje të ngushtë me udhëheqësit e rezistencës kundër bashkimit me Kishën e Romës. Njëri prej këtyre udhëheqësve ishte duka i madh Lukë Notari, admiral i njohur i flotës dhe kryekomandant i ushtrisë bizantine. Është interesant se pikërisht ky komandant në prag të rënies së Konstantinopojës i pat thënë fjalët e njohura: "Më mirë vlen turbani i sullatnit se tiara e papës". Dëshira e tij u realizua: Haia Sofia-Kisha e Madhe në Stamboll u shndërrua në xhami dhe nga maja e kupolës së madhe u hoq kryqi dhe u vendos gjysmëhëna.

Shqipëria e asaj kohe në pjesën veriore i takonte arealit kulturor-shpirtëror latin, kurse në jug atij greko-bizantin. Mirëpo, për nga aspekti kishtar e tëra i takonte Romës. Fundja duhet theksuar se kisha e krishterë ndër shqiptarë, si ajo e ritit latin ashtu edhe ajo e ritit greko-bizantin, përherë është mbajtur anash konflikteve që zhvilloheshin midis Romës dhe Konstantinopojës. Përkundrajt disa luhatcheve të përkohshme, kleri i të dy riteve i ka mbetur besnik Kishës së Romës.

Njësoj ishte situata edhe me dinastitë dhe strukturat e tjera laike shqiptare. Sadoqë disa dinasti, e sidomos ato që i takonin ritit greko-bizantin, ishin në luhatche e sipër në mes Konstantinopojës dhe Romës, me siguri mund të thuhet se në kohën e

Skënderbeut të gjithë ishin në anën e Romës. Ky konstatim vlen, sidomos, për shtëpinë e Kastriotëve, domeni i së cilës shtrihej që nga Mati e deri në Prizren. Në të vërtetë, kjo shtëpi, me breza të tërë ka qenë e lidhur me ipeshkëvit latinë, gjegjësisht, të ritit romak dhe jo vetëm në shek. XIV-të dhe XV-të, por edhe më parë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se në Shqipërinë e kohës së Skënderbeut, asnjëri nuk është ndier as grek e as latin, por kristian perëndimor. Këtë më së miri e ka shprehur Noli në librin e tij mbi Skënderbeun, i cili është edhe doktorati i tij, kur thotë: "Katholikizma nga njëra anë i jipte Shqipërisë bashkimin që i mungonte si shtet, edhe nga ana tjetër, e lidhte me botën e krishterë europiane. Ajo", vazhdon Noli, "në Shqipëri ishte si një protestë kundër zotërimit bizantin dhe serp". Ja, pra, në këtë rrezatim shpirtëror e kulturor por edhe politik, lindi Gjergj Kastrioti.

Data e saktë se kur është lindur ende nuk është dëshmuar. Mendohet sa ka lindur më 1405. I ati i tij, Gjoni, i mundur nga turqit që i detyruar që birin e tij Gjergjin, së bashku me vëllezërit e tjerë t'ia japë peng sulltan Muratit II. Falë natyrës së zgjuar Gjergji shpejt përparon dhe bën një karrierë magjepsëse ushtarake. Mbi rininë e tij deri në kthimin në Shqipëri shumë pak njihet. Dihet vetëm se në nëntor të vitit 1443, pas fitores mbi Turqit në betejën e Nishit, me dinakëri kthehet në Krujë ku shpalli pavarësinë e tij nga sulltani dhe publikisht deklarohet si i krishterë. Më 1444, në Lezhë e mbledh kuvendin ku marrin pjesë të gjithë krerët e Shqipërisë, dhe themelon lidhjen e parë shqiptare, të njohur si Lidhja e Lezhës, qëllimi i së cilës ishte lufta e përbashkët kundër turqve. Në këtë kuvend Skënderbeu njëzëri zgjidhet kryekomandant i ushtrisë

shqiptare që përbëhej nga njësi të ndryshme të dinastëve shqiptarë. Nga viti 1444 e deri më 17 janar 1468, kur vdes në Lezhë nga ethet, pasi kungohet dhe varroset në kishën e Shën Kollit në Lezhë, ai zhvillon 22 beteja ngadhënjese. Luftoi kundër dy sulltanëve më të fuqishëm të asaj kohe: sulltan Muratit II dhe sulltan Mehmet-pushtuesit.

Pas la djalin e vogël Gjonin dhe bashkëshorten Donikën. Nënë e djalë u strehuan në Napoli tek Ferdinand Aragonasi, i biri i Alfonsit. Për shak të terrorit që bënin turqit dhe për të ruajtur identitetin e tyre kulturor e fetar, fillon eksodi apo braktisja e vendlindjes së shqiptarëve, të cilët u strehuan në jug të Italisë e Siçili si dhe në vendet e tjera europiane kristiane.

#### GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU MBROJTËS I QYTETËRIMIT KRISTIAN EVROPIAN

Papa Kalisti III (1455-1458), me origjinë spanjolle, në letrën dërguar Skënderbeut më 11 shator 1457 ndër të tjera shkruan: "Nuk ka njeri që nuk njeh veprat e tua e që nuk i ngre në qiell me lëvdatat më të larta, të mos flasë për trimërinë tënde si për një ushtar të vërtetë, për një mbrojtës të emrit të krishterë". I njëjti papë në një letër tjetër të vitit 1458, ndër të tjera thotë: "Me të vërtetë shohim se ai është pothuajse i vetmi i cili i është kundërvënë pushtimit të egër turk e nuk ka lejuar afrimin e tyre (Europës)".

Nga këto konstatime shihet qartë se si njihet dhe dëshmohet roli i Gjergj Kastriotit në mbrojtjen e qytetërimit evropian kristian. Kuptohet se për ata të cilët, duke iu falënderuar ligësisht së paraardhësve të tyre, e braktisin fenë e krishterë dhe me këtë kuptohet edhe identitetin shpirtëror kristian, një konstatim i lartëpërmendur vështirë kuptohet, madje edhe vështirë pra-

nohet. Për ata Skënderbeu edhe në kohën e botës shpirtërore bipolare kur popujt luftonin në emër të krishterizmit dhe islamizmit, është hero kombëtar. Megjithatë duhet thënë e vërteta. Skënderbeu në atë kohë ka luftuar në emër të kristianizmit, në mbrojtjen e qytetërimit kristian evropian i cili rrezikohet gjithnjë e më tepër nga sulmet turke. Këtë e thotë edhe vetë ai kur iu drejtohet pushtetmbajtësve perëndimorë për ndihmë.

Hero kombëtar Skënderbeu do të bëhet në kohën e Rilindjes kombëtare, në shekullin e XIX-të. Por lidhur me këtë çështje do të flas pak më vonë.

Për ta kuptuar më mirë rolin e tij në mbrojtjen e kristianizmit evropian duhet pasur parasysh si ishte Europa në shekullin XV-të.

Politikisht, Europa e asaj kohe është dhe nuk është Europë. Para shek. XV-të emri Europë ishte vetëm një nocion gjeografik. Në kohët antikë, kur ajo paraqiste vetëm një krahinë të vogël në pjesën "europiane" të ngushticës së detit të Stambollit, ideja e tërësisë së saj kontinentale, politikisht paraqitej në suazat e Perandorisë Romake, kurse në aspektin kulturor, në traditën greko-romake. Në Mesjetë kjo tërësi kuptohej dhe shprehej si kristianitet (lat. *christianitas*), gjegjësisht bashkësia politike kristiane. Mirëpo, me shfaqjen e humanizmit si drejtim letrarofilozofik, fillon ringjallja e gjuhëve kombëtare dhe me këtë edhe theksimi i veçantive kombëtare me kërkesë të të drejtave vetanake. Me një fjalë Europa e shek. XIV-të dhe XV-të politikisht ishte e përçarë me lëvizje populiste, të përshkuara me mësim fetare sektashe dhe heretike siç ishin galikanizmi në Francë, germanizmi antiromak në Gjermani, huzitizmi në Çeki etj. Në planin politik Europa ishte e ngarkuar me kundërthënie midis shtete-

ve dhe luftës civile. Kuptohet se një Europë e tillë, e përçarë, nuk ishte në gjendje t'i kundërvihej fuqisë aziatike e cila tashmë ishte, si të thuash, para dyerve të saj. Uniteti politik i Europës ishte vetëm ideal apo më mirë të themi, vetëm një ëndërr. Së këndejmi në gjirin e Kishës perëndimore apo latine shpërtheu plasaritja dhe përçarja. Kuptohet, Kisha katolike ishte e vetmja fuqi e cila ishte në gjendje të merrte rolin udhëheqës në organizimin e mbrojtjes së qytetërimit kristian kundër furisë shkatërruese të ushtrisë osmane. Pikërisht në këtë kontekst dhe në këtë frymë duhet kuptuar sintagma "Perëndimi kristian" gjegjësisht "Europa kristiane".

Është më se e qartë se për njeriun e sotëm me mentalitet të laicizuar sintagma e përmendur vështirë se mund të kuptohet. Madje për shumicën është edhe e papranueshme. Mirëpo, për papët e asaj kohe një Gjergj Kastrioti ishte person në të cilin pa kurrëfarë hamendjeje kanë mundur të mbështeten. Për këtë ka qenë i vetëdijshëm edhe vetë Skënderbeu siç mund të kuptohet nga letra e tij, dërguar më 31.10.1460 Gjon Anton Orsinit, në të cilën shprehimisht thotë: "Sikur të isha shkelur unë me siguri se këtë do ta kishte ndier e para Italia". S'do mend se një shprehje e tillë e Skënderbeut nuk ishte vetëm një gjest diplomatik i diktuar nga vija e parë luftarake ballë për ballë me armikun. Kjo ishte, në të vërtetë, shprehje e besimit të thellë dhe të sinqertë. Për këtë besim e kushtoi edhe tërë jetën e tij, shkathësinë ushtarake dhe atë diplomatike. Kjo shihet edhe nga fakti se për relacione dhe komunikime diplomatike me pushtetmbajtësit evropianë të kohës i zgjedh njerëzit nga strukturat e larta kishtarë, siç ishin prifti dhe humanisti Gjon Gazuli, abati

dhe protonotari apostolik Gjergj Pelinji, Pal Engjëll-Dushi arqipe-shkëv i Krujës, Pal Engjëlli arqipe-shkëv i Durrësit. Tek e fundit edhe vetë papët ishin të vetëdijshëm për bindshmërinë e tij të thellë ndaj kristianitetit evropian dhe ndaj besimit të krishterë. Për këtë gjë flasin qartë dokumentet e papëve të Romës, që kanë të bëjnë me Skënderbeun. Atë papët e quajnë *Athleta Christi* (ushtar i krishtit), *defensor fidei* (mbrojtës i fesë) etj. Pikërisht këto emërtime, qartë dëshmojnë se bindja e tij kristiane nuk ishte e karakterit formal. Si të kuptohen ndryshe fjalët e papës Kalisti III kur thotë: "Nuk është e nevojshme të ma rekomandoni sepse unë me të jam ngushtë i lidhur shpirtërisht". Skënderbeu, në të vërtetë, në momentin më kritik për kristianitetin evropian bëhet dhe mbetet i vetmi aleat i papëve të cilët me mish e me shpirt kanë vepruar për shpëtimin e kësaj Europe. Për këtë na dëshmojnë dokumentet e tyre që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Skënderbeut. Nga ato qartë shihet se atë nuk e kanë quajtur kot me titujt e përmendur, por edhe e kanë ndihmuar financiarisht e me mënyra të tjera. Papa Kalisti III-të i dërgoi Giovanni Navaron, njërin prej këshilltarëve të tij më të njohur ushtarakë për të përpiluar plane strategjike ushtarake për luftë kundër turqve. Më vonë dërgoi edhe nipin e tij, Michele Borgian me një flotilje e cila, për fat të keq, nuk arriti në cak. Ky papë ishte i vetëdijshëm për meritat e Gjergj Kastriotit, për gjithçka që bëri në ruajtjen e krishtërit Evropian përkundër premtimeve boshe të sovranëve të tjerë laikë. Këtë e vërtetojnë edhe fjalët: "Meritat e tij janë më të mëdha se të të gjithë princëve të tjerë të krishterë".

Pasardhësi i Kalistit III-të, i njohuri Ennio Silvio Piccolomini,



i njohur si papa Piu II-të (1464-1473), diplomat i njohur, ishte i tëri i përshkuar me shpirtin e zjarrit të kryqëtarëve. Me këtë qëllim ai organizoi një kongres panevropian. Por, përveç fjalëve boshe, në këtë kongres nuk u morr asnjë vendim i prerë. Pasi mori vesh se Bosnja ra nën pushtetin turk më 1463 vendosi të ndërmarë një aksion luftarak duke besuar se edhe pushtetmbajtësit laikë do ta ndjekin pas. Përveç venedikasve të cilët ia dërguan një flotilje, papa Piu II-të në muajin qershor të vitit 1464 nisët për në Shqipëri me qëllim që të kurorëzohë mbret Skënderbeun sepse për të ai ishte: *Christi propugnator acerrimus* (mbrojtësi më i ashpër i Krishtit). Mirëpo, në udhëtim e sipër, në Ankonë, më 15 gusht të vitit 1464, papritmas vdes.

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër shihet qartë se, Europa si e tillë, falë përçarjeve, intrigave të ndërsjellta të sundimtarëve e ambicjeve personale, nuk ishte në gjendje që në mënyrë serioze dhe efikase të mbrohet nga rreziku turk. E vetmja fuqi kohezive që ka mundur ta bashkojë Europën ishte Kisha katolike dhe papati. Dhe jo vetëm kaq. Papët ishin organizatorët kryesorë të koalicionit antiturk në mbrojtjen e krishtërit të Europës së përçarë. Për turqit, të krishterët katolikë ishin armiq të shenjuar sepse ata i takonin papatit.

Venediku dhe Napoli në dallim nga papët, ndihmën ia kushtëzuan Skënderbeut. Ndërkaq edhe kjo ndihmë ishte më tepër në fjalë se në vepra. Megjithatë, Gjergj Kastrioti plot 25 vjet qëndroi në ballë të betejës kundër turqve dhe siç thotë Noli "e shpëtoi Romën dhe Europën nga katastrofa e tmerrshme që u kanosej nga pushtimi turk, që do të kishte qenë rrënim i plotë i jetës ekonomike dhe qytetërimit evropian. Pjesa që i takon Skënder-

beut në këtë shërbim jashtëzakonisht të rëndësishëm vëshirë se çmohet më tepër nga ç'duhet". Kështu e përfundon Noli veprën e tij mbi Skënderbeun. Dhe me vdekjen e heroit, shqiptar më 17 janar të vitit 1468, Europa do të humbë mbrojtësin e saj më të rëndësishëm.

#### SKËNDERBEU HERO I SHQIPTARËVE

Me rënien e Shkodrës më 1479 dhe me dorëzimin e Durrësit nga ana e venedikasve me një marrëveshje paqësore të 25 prillit të vitit 1479, Shqipëria praktikisht, ekonomikisht dhe shpirtërisht bëhet pjesë e Perandorisë Osmane. Që nga kjo kohë në dokumentet historike quhet Albania Turcica (Shqipëria Turke). Me kalimin në islamizëm, pa marrë parasysh me vullnet apo me dhunë, jo vetëm të strukturave të pasura nëpër qendrat urbane, por edhe të atyre fshatare, fillon për fat të keq, shndërrimi i identitetit shpirtëror të shqiptarëve në dem të atij evropian. Pastaj "me islamizimin masiv", siç thotë profesor Aleks Buda, "që përfshiu pothuaj dy të tretat e popullit shqiptar, u krijua një faktor ndryshueshmërie, që pati pasoja fatkeqe për Ballkanin dhe veçanërisht për Shqipërinë, sepse krijoi një varg elementesh grindjeje në gjirin e familjes së popujve ballkanikë dhe në gjirin e popullit shqiptar". Me qëllim të ruajtjes së identitetit etnokulturor dhe shpirtëror, por edhe nga dhuna e paskrupullturke mbi popullatën e krishterë, fillon episodi apo largimi i popullatës shqiptare të krishterë nga Shqipëria. Kuptohet se kjo popullatë, përveç dokeve e zakoneve, me vete merr edhe kujtesën mbi Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Duke e shfrytëzuar emrin e tij, Jeronim de Rada (1814-1903), poeti i madh arbëre-

sh, vë në pah çështjen e popullit shqiptar para pushtetmbajtësve evropianë, duke kërkuar prej kësaj Europe, për lirinë e së cilës pat luftuar Skënderbeu, që ta heqë velin e heshtjes dhe të ndërmarë në konkretisht aksione për kauzën shqiptare dhe çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha turke.

Emri i Skënderbeut në kohën e Rilindjes kombëtare, për shqiptarët u bë fuqi mobilizimi në luftë kundër turqve. Përveç de Radës, rol të rëndësishëm luajti edhe Naim Frashëri (1846-1900), që i takonte rendit të bektashinjëve. Ai shkroi veprën *Istori e Skënderbeut*. Për ta kuptuar këtë sa më mirë duhet të njihim rrethanat e shek. XIX-të. Ishte shekulli i romantizmit, por edhe i lëvizjeve çlirimtare të popujve të Ballkanit. Të krishterët e Ballkanit në luftë për çlirimin kombëtar shkonin me klithjen: "Për kryqin e ndershëm dhe lirinë e artë". Mirëpo, një klithje e tillë ndër shqiptarët muslimanë ishte e pamundur dhe e kotë sepse siç thotë Ismail Kadareja: "Turqizimi i qindra mijëra shqiptarëve, greqizimi i një pjese tjetër, ngatërimi i përkatësisë shqiptare me atë fetare, dëshmonte se ndjenja patriotike e një pjese të tyre ishte jo aq e fortë siç paraqitej". E rilindasit për ta zgjuar ndjenjën kombëtare ndër gjithë shqiptarët, pra edhe të atyre të besimit musliman, mbështeteshin në personalitetin e Skënderbeut, duke krijuar prej tij një shembëlltëritë mitike. Naim Frashëri konsideronte se bektashizmi duhet të jetë besimi i përbashkët i të gjithë shqiptarëve, pasi ai bazohet si në Bibël ashtu edhe në Kuran. Në këtë frymë duhet kuptuar edhe nocioni "hero kombëtar" lidhur me Skënderbeun.

**Dr. Zef Mirdita**

## RAFINERIA E PARE PËR BIODIZEL HAPET NE BRAZIL

Presidenti i Brazilit, Luiz Inacio Lula da Silva, inaguroi rafinerinë e parë të lëndës djegëse biodizel në këtë vend. Kryetari Lula deklaroi se "në të ardhmën nafta nuk do të jetë një arsye për të luftuar, apo për të pushtuar shtetet që prodhojnë naftë". Ai gjithashtu shtoi se "jemi duke i treguar botës që nafta mund të prodhohet edhe nga burimet e ripërtëritshme".

Rafineria në Soymina do të prodhojë 12 milion litra biodizel në vit nga farat e bimëve vajore si luledielli dhe soja.

Brazili është duke udhëhequr si prodhuesi më i madh i lëndëve djegëse me origjinë bimore. Shoqëritë industriale braziliane prodhojnë avionë dhe automjete të cilat përdorin etanolin në vend të naftës apo benzinës. Përparësia për vendin është se nuk varet nga nafta e huaj, si dhe nuk ndot mjedisin përreth.

## MICROSOFT TENTON PATENTIMIN E IPV6

Microsofti është kritikuar rëndë edhe për një veprim i cili kishte për qëllim "patentimin e internetit". Public Patent Foundation apo PUBPAT pohon që patenta për të cilin ka aplikuar grupi i Bill Gates para disa viteve është e pavlefshme pasi puna e bërë më parë nga Internet Engineering Task Force (IETF) nuk është dëshmuar.

Patenta 6101499, e titulluar "Mekanizmi dhe programi kompjuterik për gjenerimin automatik të IP adresave" i është dhuruar Microsoftit në vitin 2000 (MS ka aplikuar më 1998).

Daniel Ravicher, nga PUBPAT, është brengosur që kjo patentë do të pengojë zbatimin e IPv6. Ai shton se "Microsoft nuk do t'a shfrytëzojë patentën - e dinë që është e panevojshme por do të ketë njerëz që do të frikësohen nga kjo".

Rregulla për patentim është që metodat apo mekanizmat të cilat janë publikuar më parë nuk mund të patentohen, gjë që është rasti i IPv6. Gjatë aplikimit, Microsofti nuk i tregoi dokumentat ekzistues nga IETF.

IPv6 është versioni i ri i protokollit të sotëm IP dhe është parashikuar për ta zgjeruar kapacitetin e internetit. Zbatimi i IPv6 ka filluar ngadal IP dhe shpresohet që pas 20 viteve protokollit do të kthehet në standard. Kina ka filluar gjithashtu përdorimin e IPv6.

## BIMET VETERREGULLOJNE KODIN E TYRE GJENETIK

Zbulimet e biologëve molekularë nga Purdue University kundërshtojnë besimet e vjetra që gjenet, çfarëdo që të jenë, transmetohen nga prindërit tek fëmijët. Sipas biologëve, bimët kanë aftësi të rregullojnë gjenet e dëmtuara dhe të vazhdojnë të zhvillohen sikur paraardhësit më të vjetër edhe nëse prindërit e tyre kishin difekte.

Kjo kundërshton besimin e shkencëtarit gjenetik të parë, Gregor Mendel, nga mesi i 1800, sipas të cilit difektet trashëgoohen tek pasardhësit. Ende nuk dihet se a kanë edhe njerëzit aftësi të tilla, por kjo tregon që trashigimia është shumë më fleksibël sesa mendohej më parë.

Nga eksperimentet, hulumtuesit zbuluan që bimët nuk përmbajnë ndonjë plan të ADN-së, sipas të cilës ajo rregullohet, si dhe nuk mundën të konkludojnë se a ekziston ndonjë gjen special roli i të cilit është t'i korrigjimi i difekteve.

Biologët do të vazhdojnë të hulumtojnë dhe eksperimentojnë edhe tek kafshët për të parë nëse ekziston kjo dukuri edhe te njerëzit.

*Përmbledhur nga Genc B. Kastrati*  
<http://www.pr-tech.net>



Anëtarë të nderuar të Albshkencës, kam nderin t'ju flas për Wikipedian në shqip e cila është pjese e projektit ndërkombëtar Wikimedia, e bazuar në softuerin për punë bashkëpunuese on-line WikiWikiWeb. Fuqia e Wikit qëndron tek mundësia e çdokujt për të shtuar material dhe përmirësuar atë ekzistues.

Si e tillë, Wikipedia ka karakter paksa populist megjithëse projektet në gjuhët e tjera e veçanërisht ata në anglisht e gjermanisht, me respektivisht mbi 500.000 dhe mbi 200.000 artikuj, i kanë tejkaluar edhe parashikimet e pesimistëve si në sasi ashtu edhe në cilësi.

Për momentin, ne kemi rreth 100 anëtarë dhe vetëm një nu-

## Projekti Wikipedia në shqip

mër i vogël i tyre është aktiv në shkrimin dhe korrigjimin e artikujve. Në kohën kur shkrimi i artikujve posa ka marrë hov dhe drejtimi që marrin politikat udhëzuese të redaktimit do të ketë pasoja në nivelin e suksesit tonë të mëvonshëm, ndihma nga njerëz me përvojë në projekte të ngjashme apo njerëz me njohuri enciklopedike është e mirëseardhur.

Për ne shqiptarët, kjo mundësi që na ofrohet absolutisht pa kurrfarë pagese në një infrastrukturë të përgatitur nga të tjerët, jep mundësinë e krijimit të një vetëdijeje gjithëshqiptare prej caqeve më periferike të trojeve shqiptare si dhe afrimin

e tri qendrave të mëdha universitare shqiptare në një laborator të përbashkët të gjuhës, kulturës dhe historisë kombëtare e më gjerë. Për suksesin tonë nuk kam dyshim pasi edhe pse koncepti WikiWiki u mendua nga një person i vetëm sot vetëm në Wikipedia përpunohen rreth 1.000.000 artikuj në rreth 122 gjuhë të ndryshme.

Jeni të mirëseardhur ti bashkangjiteni ekipit dhe ta bëni Wikipedian pjesë të jetës suaj të përditshme intelektuale.

Për më shumë informacion vizitoni: <http://sq.wikipedia.org>

**Arianit Dobrosht**

### LIBRA TË RINJ TË SHKENCAVE TË SAKTA DHE SHKENCAVE TË NATYRËS

#### *Teknologjia kimike dhe mjedisore*

Autorë: Dh. Haxhimihali, N. Jana  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-157-9

#### *Grafika inxhinjrike Pj. 1, 2*

Autorë: K. Borkshi, F. Luga, L. Pano  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-190-0

#### *Hidraulika e përgjithëshme*

Autori: Isuf Reçi  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-193-5

#### *Qendrueshmëria e strukturave*

Autori: Forcim Softa  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-192-7

#### *Teoria e strukturave. Dinamika*

Autori: Niko Pojani  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-188-9

#### *Algoritme të telekomit*

Autori: Safet Likaj

Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-177-3

#### *Ushtrime të analizës matematike*

Autorë: V. Kabili, A. Haxhimusai, M. Qirko, Sh. Leka, L. Gjoka, L. Hanelli, H. Binjaku, S. Hysko  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-191-

#### *Zoologjia dhe evolucioni i vertebrorëve*

Autor: Niko Peja  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-172-2

#### *Bazat e farmakologjisë klinike*

Autor: Florika Mandro, Sonila Jani  
Botoi: Lilo  
ISBN: 99927-35-61-9

#### *Inxhinjria kimike 2*

Autor: Petrit Dodbiba  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-161-7

#### *Udhëzues për punë laboratorike*

Autor: Grup autorësh  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-174-9

#### *Kimia e dukurive sipërfaqësore*

Autor: Ilo Mele  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-156-0

#### *Teknika dhe metodika e eksperimenteve kimike*

Autor: Loreta Pashko  
Botoi: SHBLU

#### *Teknologjia kimike dhe mjedisore*

Autor: Dh. Haxhimihali, N. Jana  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-157-9

#### *Procedura ekzaminimesh pranë shtratit të të sëmurit*

Autori: Iliriana Ruka  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-180-3

#### *Hemoglobinopatitë dhe shtatëzania*

Autori: Shpresa Metushi (Thomaj)  
Botoi: Geer  
ISBN: 99927-767-8-1

#### *Terapia stomatologjike*

Autori: Pavli Kongo  
Botoi: SHBLU  
ISBN: 99927-0-173-0

## AKADEMIA KOMBETARE E SHKENCAVE TE AMERIKES

[Kam kohë që e ndjek nga afër Alb-Shkencën (disa nga anëtarët e saj i kam njohur që vite më parë), pavarësisht se nuk jam bërë asnjëherë anëtar i saj].

Në lidhje me diskutimin mbi gjendjen dhe të ardhmen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë kam dashur me kohë të shkruaj diçka mbi statusin e sotëm të saj. Një gjë që më ka vlarë syrin qysh herët është se shpesh botimet që bëhen nga punonjës të kësaj akademie në organet e shtypit, botohen nën emrin personal dhe jo nën siglën e akademisë. Kur një punonjës (shkencëtar) merr përsipër një studim nga academia dhe paguhet nga shteti, duhet (mendoj unë) që punimi i tij të dalë me firmën e akademisë së shkencave dhe jo me emër personal.

Më poshtë po jap me pak fjalë organizimin dhe funksionimin e Akademisë Kombetare të Shkencave të SHBA-së ([www.nationalacademies.org](http://www.nationalacademies.org)) me qendër në Washington, DC.

Kam 6 vjet që punoj në këtë akademi dhe kam krijuar një ide pak a shumë të qartë se si funksionon kjo akademi brenda shtetit amerikan.

NAS (National Academy of Sciences) është krijuar me vendim të Kongresit amerikan në

vitin 1863 dhe përbëhet nga National Academy of Sciences, National academy of Engineering (NAE), Institute of Medicine (IOM) dhe National Research Council (NRC). NRC është krahu operativ i Akademisë së Shkencave.

Duhet thënë qysh në fillim që në këtë Akademi nuk ka shkencëtarë të punësuar. Qenia anëtar i kesaj akademie është një nder shumë i madh për shkencëtarët në mbarë botën dhe çmimet që jep kjo akademi janë të dytët për nga rëndësia, bas çmimit Nobel.

Akademi amerikane është krijuar nga qeveria federale për të qenë këshilltare e saj në çeshtje shkencore dhe teknologjike. Megjithatë ajo është institucion privat dhe nuk merr fonde nga qeveria federale (d.m.th. nuk figuron në buxhetin e shtetit). Studimet e ndërmarra nga kjo akademi zakonisht financohen nga buxheti i ministrive (federal agencies). Shumica e studimeve që kryhen nga kjo akademi bëhen me kërkesë të qeverisë (në këtë rast të ministrive përkatëse). Për saktësi fondet e qeverisë financojnë 85% të studimeve që kryhen; pjesa tjetër janë fonde private. Mbështetja e qeverisë me fonde bëhet nëpërmjet kontratave dhe granteve. Personeli i akademisë është kryesisht administrativ dhe arrin rreth 1100 punonjës.

Si funksionon kjo akademi normalisht?

Qeveria (ministra përkatëse, apo edhe kongresi) i kërkojnë a-

kademisë që të bëjë një studim, në çfarëdo sferë të jetës: mjekësi, mjedis, transport etj. dhe japin edhe fondet për këtë qëllim. Drejtori (që është zakonisht shkencëtar) i drejtorisë përkatëse (sipas sferës së studimit) krijon grupin e studimit duke thirrur në këtë grup shkencëtarët më të mirë në këtë fushë, që mund të jenë në institute të tjera shkencore apo edhe nga vende të tjera. Zakonisht studimi ka një afat që shkon nga gjashtë muaj deri në disa vite. E veçanta e grupit të studimit është që shkencëtarët që bëjnë pjesë në këtë grup, nuk marrin rrogë d.m.th. nuk shpërblehen për punën që bëjnë. Me paratë e financuara mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të pergatitjes së raportit përfundimtar.

Përveç këtyre studimeve (study projects) që përbëjnë edhe shumicën e punës së akademisë, ajo ka edhe role të tjera të rëndësishme më pak të njohur, si administrimi afatgjatë i fellowshipeve, programeve associateship, etj.

Akademia është një organizatë non-profit d.m.th. nuk i lejohet të krijojë fitim. Ajo ka lidhje të gjera në të gjithë botën me akademitë e tjera të shkencave. Megjithëse me sa di unë nuk ka asnjë kontakt me atë shqiptare.

Për më tepër mund të shihni [www.nationalacademies.org](http://www.nationalacademies.org).

**Albert Llaguri**

### Biologjia online një blog shqiptar

Biologjia online është një përpjekje modeste për të sjellë biologjinë bashkëkohore pranë të gjithë atyre që janë të apasionuar pas saj. Tek biologjia online ju do të gjeni jo vetëm një përmbledhje të artikujve më të fundit të botuar në revista prestigjioze, por edhe metoda, databases, programe për të përpunuar të dhënat e të tjera me radhë.

Te gjithë ata që janë të interesuar për biologjinë dhe gjenetikën duhet të vizitojnë faqen në internet në adresën: <http://biologji.blogspot.com/>

Faqja administrohet nga Dr. Albana Rexhepaj e cila ushtron aktivitetin e saj shkencor në Zvicër, në fushën e biologjisë molekulare dhe gjenetikës .

Shqipëria ka pasur një fenomen masiv emigrimi nga fillimi i viteve '90. Ky aspekt i rëndësishëm i regjimit demografik ishte pothuajse i pa njohur para këtyre viteve, kur shoqëria shqiptare ishte një shoqëri e mbyllur.

Pra përbërësi kryesor që përcakton regjimin demografik të viteve të fundit bëhet emigrimi, me 15% të popullsisë.

Italia dhe Greqia mbeten vendet kryesore të emigrimit të shqiptarëve. Ky fakt ka ndodhur si nga afërsia gjeografike e kulture ashtu edhe nga vështirësia për të zgjedhur një rrugë të rregullt dhe legale.

Gjatë vitit 1997 Shqipëria paraqet treguesit normalë të raportit të emigrimit legal/klandestin. Në fillim të atij viti në Itali rezultoni të legalizuar 62.000 emigrantë shqiptarë ndërkohë që numri total i tyre në këtë vend ishte rreth 100 000. Raporti mes emigrantëve legalë dhe jo legalë ishte më i lartë në Greqi: rreth 350.000 emigrantë ku jo më shumë se 100.000 ishin të legalizuar.

Në emigracionin shqiptar dominojnë më shumë meshkujt se sa femrat. Në Itali ata përbëjnë 70.9 % të emigrantëve.

Pas viteve '90 emigracioni është konsideruar si një ndër elementët kryesorë për të përballuar jetën dhe siguruar të ardhmen, veçanërisht ekonomike, të individit, të familjes dhe shoqërisë shqiptare. Rritja e faktorëve që shtynë njerëzit të lenë vendin e tyre drejt një vendi tjetër, nuk kanë qenë vetëm paqartësitë që solli kriza, por edhe dobësimi i faktorëve tërheqës që vjen nga kontraditat e shumfishta, përvojat individuale dhe rritja e pengesave për emigrimin dhe integrimin e emigrantëve.

Ne çdo rast, motivet kryesore

të emigracionit shqiptar mbeten situata ekonomike e vendit dhe nevoja e rritjes, ndërsa burimet e brendëshme jo të përdorura si duhet për momentin, do të ndikojnë tek emigracioni në vitet pasuese.

**INTEGRIMI SOCIAL**

Niveli i integritit të emigrantëve shqiptarë në Itali dhe Greqi dhe problematika e marrdhënieve me popullsinë e këtyre vendeve janë të ngjashme. Edhe marrdhëniet me institucionet e shërbimit social në këto vende kanë pak a shumë të njejtën tipologji. Po bëhen çdo ditë përpjekje për të përmirësuar raportin mes numrit të emigrantëve klandestinë dhe atyre të legalizuar.

Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë në Itali e Greqi punojnë në sektorin e ndërtimit dhe të bujqësisë (meshkujt) dhe në shërbimet shtëpiake (femrat). Punësimi në këto sektorë është më shumë një faktor mbijetese, se sa një faktor integrimi, civilizimi dhe emancipimi.

Imazhi i emigrantëve shqiptarë më shumë është i krijuar nga shtypi dhe televizioni se sa ai që vjen nga përvoja e marrdhënieve që ata ndërtojnë me popullsinë e vendeve ku kanë emigruar.

Fakti që shqiptarët punojnë kryesisht në këta sektorë të vështirë, në punë të zezë, jo legale tregon edhe mungesën e vëmendjes së organeve shqiptare për integrimin e tyre dhe e shndërron jetën sociale të bashkësisë së emigrantëve shqiptarë në të mekur dhe pa peshë.

Studiuesit dhe ekspertët për emigracionin në këta vende demostrojnë që opinioni negativ mbi shqiptarët vjen kryesisht nga persona që nuk kanë pasur

asnjeherë kontakte të drejtpërdrejta me shqiptarët.

Potenciali emigrues i shqiptarëve me kalimin e viteve nuk ka rënë, sidomos pas vitit 1997. Kjo situatë ka ardhur nga mos përdorimi racional i të ardhurave që hyjnë në Shqipëri nga emigrimi, nga situatat e komplikuar në atdhe dhe nga mungesa për një periudhë të gjatë kohe, të një strategjie kombëtare për emigracionin dhe në veçanti për ata emigrantë që kthehen përgjithmonë në atdhe.

Gjermania ka filluar disa projekte të bazua në dhënien e kredive bankare për emigrantët që kthehen në Shqipëri për të patur mundësi të nisin aktivitetet ekonomike.

Shtytja kryesore që i bën emigrantet të kthehen në Shqipëri është falimentimi i iniciativave të tyre. Pjesa më e madhe e atyre që kthehen i përkasin kategorise që nuk kanë mundur të integrohen me sukses në shoqëritë e vendeve pritëse, ose të detyruar nga fshesat e policisë.

Fenomeni i jo suksesit është i shpjegueshëm duke marrë në konsideratë kushtet e emigrimit klandestin.

Marrveshjet e bera kohet e fundit me vendet fqinje në fushën e emigracionit, duke përdorur mekanizma të rinj, duke ulur rraportin mes emigrantëve klandestin dhe atyre legal, mund të sjellë ndryshime pozitive duke krijuar perspektiva të mira të përfitimeve, kështu për të motivuar kthimin në atdhe për të investuar

\*Student për Marrdhënie ndërkombëtare dhe diplomatike University of Genoa, Itali

Prandaj, Fan Stilian Noli do të përkujtohet jo vetëm për veprimtarinë e tij voluminoze dhe përpjekjet e tij në emër të interesit kombëtar. Ai përkujtohet sot sepse ai ndihmoi në hedhjen e themeleve të gjera të një qëllimi kombëtar të bazuar në kultivimin dhe vlerësimin e asaj që vlerësohet nga i gjithë njerëzimi. Duke bërë këtë, ai nderoi veten, popullin e tij dhe Zotin.

*(Kumtesë me rastin e 70 vjetorit të Qeverisë Demokratike të vitit 1924, Tiranë, 1994).*

At Artur Liolin është kancelar i Kryepeshkopatës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, themeluar prej imzot Fan Nolit dhe famulltar në Katedralen e Shën Gjergjit në Boston.

Në fillim të studimeve, at Arturi u interesua për fushën e mjekësisë e biologjisë dhe fitoi disa çmime shkencore si: Navy Science Award dhe çmimin e parë të New York Science Fair. Më pas punoi si kërkues në laboratorin e mirënjohur të kancerit Sloan-Kettering Institute for Cancer Research. Në të njëjtën kohë studioi në shkollën e famshme muzikore Juilliard për organo e piano. Studimet e larta i mbaroi në fushën Histori arti (të Mesjetës dhe bizantine) në Universitetin Princeton, ku u diplomua me nderime të larta (Summa cum laude) në vitin 1967. Gjithashtu ai kreu studime në Institutin Albert Schweitzer në Zvicër në programin: "Krizat në qytetërimin perëndimor" me hulumtime ekonomike, kulturore, historike dhe filosofike. U dekorua me titullin Woodrow Wilson Scholar më 1967 dhe nga Universiteti Harvard më 1968 (Robert Woods Bliss Fellow). Si student e më vonë si prift, ka shkruar artikuj rreth çështjes shqiptare në gazetën *Dielli* dhe për revista si *Liria*, *Illyria*, *Koha* e *Jonë* etj.

## NGA JETA NE ALB-SHKENCE

Po vërejmë me kënaqësi që faqja jonë në internet në adresën [www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org) vazhdon të vizitohet rregullisht nga vizitorë nga shumë vende të botës. Numri total i anëtarëve e ka kaluar numrin 250 dha ai i vizitave po i afrohet shifrës 4600.

- Do të jetë me shumë interes gjithashtu që të vazhdonim të pasuronim fjalorthët terminologjikë të instaluar në faqen tonë. Gur-gur bëhet kalaja, thotë populli. Ne i kemi të gjitha mundësitë që të hartojmë si Alb-Shkencë disa fjalortha terminologjikë anglisht-shqip me terma të degëve ku ushtrojmë veprimtarinë tonë shkencore.

- Gjithashtu ne kemi krijuar edhe një lidhje të veçantë për Seksionet e Alb-Shkencës, të cilat mund të shërbejnë si pika takimi të studjuesve të së njëjtës degë. Aty mund të shkëmbehet informacion i profilizuar si dhe mund të vendosen kontakte të cilat mund të shërbejnë më vonë për të realizuar bashkëpunime të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

- Në faqen tonë mund të lexoni edhe të gjithë numrat e buletineve të Alb-Shkencës të botuar deri më sot. Kemi vënë re se interesi për këtë buletin është në rritje dhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës kanë shprehur dëshirën të botojnë shkrimet e tyre në këtë buletin. Ky kontribut është i mundur për të gjithë anëtarët prandaj do t'ju kërkoni që të dërgoni shkrimet e sugjerimet tuaja pa hezitim. Ne do të vazhdojmë të punojmë sistematikisht e në vazhdim në mënyrë që ta shndërrojmë këtë buletin në një organ sa më dinjitoz të Alb-Shkencës, këtij grupimi virtual të studiuesve shqiptarë nga e gjithë bota.

- Do t'ju luteshim që të gjitha njoftimet për vende pune t'i dërgoni në adresën [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org). Ne kemi krijuar një lidhje të veçantë në faqen tonë në internet ([www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org)) ku do të afishojmë njoftimet për vende pune. Këto njoftime nuk do të shpërndahen më në listën e mesazheve të forumit tonë.

*P.S. Po patët probleme me hyrjen në portalin e Alb-Shkencës ju jutemi na shkruani menjëherë në adresat e mësipërme apo mund të kontaktoni drejtpërdrejt me Neim Rustemin ([neim.rustemi@orkla.brands.no](mailto:neim.rustemi@orkla.brands.no)) i cili administron dhe ndjek mbarëvajtjen faqen dhe portalit të Alb-Shkencës.*